



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës : KSC-BC-2020-06

**Prokurori i Specializuar k. Hashim Thaçit, Kadri Veselit,
Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit**

Vendosi: Trupi Gjykues II

Gjykatës Çarls L. Smith III, Kryegjykatës

Gjykatës Kristof Barte

Gjykatës Ginel Metro

Gjykatës Fergal Gejnor, gjykatës rezervë

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 10 shkurt 2026

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Vendim mbi Rishikimin e Rregullt të Paraburgimit të Hashim Thaçit

Zyrës së Prokurores së Specializuar

Kimberli P. Uest

Mbrojtjes së Hashim Thaçit

Luka Mishetiç

Mbrojtjes së Viktimave

Sajmon Loz

Mbrojtjes së Kadri Veselit

Rodni Dikson

Mbrojtjes së Rexhep Selimit

Xhefri Roberts

Mbrojtjes së Jakup Krasniqit

Venkatesvari Alagenda

TRUPI GJYKUES II i Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Trupi Gjykues”), në bazë të neneve 41(6), (10), dhe (12) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”) dhe rregullave 56(2) dhe 57(2) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Rregullorja”), lëshon këtë vendim.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Historiku procedural në lidhje me rishikimin e rregullt të paraburgimit të Hashim Thaçit (“z. Thaçi”) është paraqitur gjerësisht në vendime të mëparshme. Zhvillimet relevante që nga rishikimi i fundit i rregullt i paraburgimit (“Vendimi i Njëzetekatërt mbi Paraburgimin”)¹ përfshijnë si vijon:
2. Më 18 dhjetor 2025, Trupi Gjykues mbylli fazën e paraqitjes së provave në këtë çështje gjyqësore.²
3. Më 19 dhe 20 janar 2026, palët dorëzuan dosjet gjyqësore përfundimtare dhe Mbrojtja e Viktimave dorëzoi deklaratën lidhur me ndikimin e krimeve të pretenduara te viktimat pjesëmarrëse në proces.³

¹ F03619, Trupi Gjykues, *Vendim mbi Rishikimin e Rregullt të Paraburgimit të Hashim Thaçit*, 10 dhjetor 2025.

² F03639, *Njoftim në lidhje me Mbylljen e Paraqitjes së Provave*, 18 dhjetor 2025.

³ F03664, Mbrojtja, *Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Mbrojtjes së Thaçit*, 19 janar 2026, konfidenciale, me Shtojcat 1-2, konfidenciale; F03668, Mbrojtja, *Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Mbrojtjes së Krasniqit*, 20 janar 2026, konfidenciale, me Shtojcat 1-3, konfidenciale, dhe Shtojcën 4, konfidenciale dhe *ex parte*; F03666, Mbrojtja, *Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Mbrojtjes së Kadri Veselit*, 19 janar 2026, konfidenciale, me Shtojcat 1-2, konfidenciale; ³ F03665, Mbrojtja, *Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Mbrojtjes së Selimit*, 19 janar 2026, konfidenciale, me Shtojcën 1, konfidenciale; ³ F03667, Mbrojtja, *Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Prokurorisë*, 20 janar 2026, konfidenciale, me Shtojcat 1-2, konfidenciale; F03663, Mbrojtja e Viktimave, *Deklaratë e Mbrojtjes së Viktimave lidhur me Ndikimin e Krimeve të Pretenduara te Viktimat Pjesëmarrëse në Çështjen 06*, 19 janar 2026, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*, me Shtojcën 1 konfidenciale, dhe Shtojcën 2, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte* (versioni i redaktuar konfidencial u dorëzua më të njëjtën ditë, F03663/CONF/RED).

4. Më 21 janar 2026, Zyra e Prokurorit të Specializuar ("ZPS") dorëzoi parashtrimet në lidhje me rishikimin e paraburgimit të z. Thaçi ("Parashtrimet e ZPS-së").⁴

5. Mbrojtja e z. Thaçi ("Mbrojtja e Thaçit") nuk dorëzoi kundërpërgjigje.

II. PARASHTRIMET

6. ZPS-ja parashtron se paraburgimi i z. Thaçi vazhdon të jetë i përligjur.⁵ Sipas ZPS-së, që nga vendimi i fundit mbi rishikimin e paraburgimit të z. Thaçi, nuk ka pasur asnjë ndryshim thelbësor të rrethanave që do të përligjte një përfundim të ndryshëm.⁶ Në fakt, sipas ZPS-së, me dorëzimin e dosjes përfundimtare të ZPS-së, z. Thaçi është edhe më shumë i informuar lidhur me volumin dhe cilësinë e provave inkriminuese kundër tij, duke rritur kështu rrezikun e arratisjes, pengimit dhe kryerjes së krimeve të mëtejshme.⁷ ZPS-ja parashtron se asnjë kusht përveç paraburgimit në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara ("objekti i paraburgimit i DHS-së") nuk do të mjaftonte për të zvogëluar rreziqet e renditura në nenin 41 dhe se paraburgimi vazhdon të jetë proporcional.⁸

III. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

7. Dispozitat ligjore përkatëse për të vendosur në çështjen aktuale përfshihen në nenin 41 dhe rregullat 56 dhe 57 dhe janë shtjelluar gjerësisht në vendime të mëparshme.⁹ Trupi Gjykses do t'i zbatojë këto standarde në këtë vendim.

⁴ F03669, Prokurorja e Specializuar, *Parashtrim i Prokurorisë në lidhje me Rishikimin e Rregullt të Paraburgimit të Hashim Thaçit*, 21 janar 2025.

⁵ Parashtrimet e ZPS-së, para. 1, 10, 33.

⁶ Parashtrimet e ZPS-së, para. 1, 11.

⁷ Parashtrimet e ZPS-së, para. 11.

⁸ Parashtrimet e ZPS-së, para. 1, 26, 33.

⁹ *Shih p.sh.*, F00994, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Rishikimin e Rregullt të Paraburgimit të Hashim Thaçit*, 29 shtator 2022, konfidencial, para. 18-21 (versioni i redaktuar publik u lëshua më 6 tetor 2022, F00994/RED).

IV. DISKUTIM

8. Qëllimi i rishikimit të paraburgimit çdo dy muaj sipas nenit 41(10) është që Trupi Gjykses të përcaktojë nëse ekzistojnë ende arsytet për mbajtje në paraburgim.¹⁰ Ndryshimi i rrethanave, ndonëse nuk është përcaktues, do të merret parasysh nëse ngrihet para trupit gjykses përkatës ose *proprio motu*.¹¹

9. Duke marrë parasysh fazën aktuale të procesit, konkretisht periudhën pas përfundimit të paraqitjes së provave nga ZPS-ja dhe paraqitjen e dëshmitarëve nga Mbrojtësi i Viktimave, Trupi Gjykses do të bëjë shqyrtimin e faktorëve sipas nenit 41(6) për t'u bindur se vazhdojnë të ekzistojnë rrethanat që përligjin mbajtjen në paraburgim të z. Thaçi.

A. KRITERET E NENIT 41

1. Dyshimi i bazuar

10. Sa i përket standardit për vazhdimin e paraburgimit, neni 41(6)(a) kërkon ekzistencën e dyshimit të bazuar se personi i paraburgosur ka kryer vepër penale që përfshihet në juridiksionin e DHS-së. Ky është kusht *sine qua non* për vlefshmërinë e vazhdimin të paraburgimit të personit të paraburgosur.¹²

11. ZPS-ja parashtron se vazhdon të ekzistojë dyshimi i bazuar se z. Thaçi ka kryer vepër penale në juridiksionin e DHS-së.¹³

12. Trupi Gjykses thekson se, në bazë të nenit 39(2), Gjykatësi i Procedurës Paraprake përcaktoi se ekzistonte dyshimi i bazuar mirë se z. Thaçi është

¹⁰ IA022/F00005, Panel i Gjykatës së Apelit, *Vendim mbi Apelin e Hashim Thaçit kundër Vendimit mbi Rishikimin e Rregullt të Paraburgimit*, 22 gusht 2022, konfidencial, para. 37 (versioni i redaktuar publik u lëshua po atë ditë, IA022/F00005/RED).

¹¹ IA010/F00008, Paneli i Gjykatës së Apelit, *Vendim mbi Apelin e Hashim Thaçit kundër Vendimit mbi Rishikimin e Paraburgimit*, 27 tetor 2021, konfidencial, para. 19 (versioni i redaktuar publik u lëshua më atë ditë, IA010/F00008/RED).

¹² *Shih* ECtHR, *Merabishvili v. Georgia* [GC], no. 72508/13, [Judgment](#), 28 November 2017, para. 222.

¹³ Parashtrimet e ZPS-së, para. 12.

përgjegjës penalisht për disa krime kundër njerëzimit (përndjekje, burgosje, akte të tjera çnjerëzore, torturë, vrasje e paligjshme dhe zhdukje me forcë) dhe krime lufte (ndalim arbitrar, trajtim mizor, torturë dhe vrasje e paligjshme) sipas neneve 13, 14(1)(c) dhe 16(1)(a).¹⁴ Gjithashtu, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstatoi se dyshimi i bazuar mirë është vërtetuar dhe në lidhje me akuzat e reja të ngritura nga ZPS-ja kundër z. Thaçi.¹⁵ Këto konstatime u bënë mbi bazën e një standardi më të lartë se ai i dyshimit të bazuar sipas nenit 41(6)(a).¹⁶

13. Në mungesë të ndonjë rrethane juridikisht thelbësore të re që do të ndikonte në konstatimet e mësipërme, Trupi Gjykses gjykon se vazhdon të ekzistojë dyshimi i bazuar se z. Thaçi ka kryer krime që përfshihen në juridiksionin lëndor të DHS-së, sipas nenit 41(6)(a) dhe (10).

¹⁴ F00026, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Konfirmimin e Aktakuzës kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit*, 26 tetor 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, para. 521(a). Versioni i redaktuar konfidencial u dorëzua më 19 nëntor 2020, F00026/CONF/RED. Versioni i redaktuar u dorëzua më 30 nëntor 2020, F00026/RED. Versioni konfidencial me më pak redaktime (F00026/CONF/RED3) u dorëzua më 5 qershor 2025. Prokurori i Specializuar dorëzoi Aktakuzën e Konfirmuar në parashtrimin F00034, Prokurori i Specializuar, *Parashtrim i Aktakuzës së Konfirmuar dhe Kërkesave lidhur me Të*, 30 tetor 2020, konfidenciale, me Shtojcën 1, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*, dhe Shtojcat 2-3, konfidenciale; F00045/A03, Prokurori i Specializuar, *Aktakuza e Redaktuar më Tej*, 4 nëntor 2020; F00134, Prokurori i Specializuar, *Version me më Pak Redaktime i Aktakuzës së Redaktuar*, KSC-BC-2020-06/F00045/A02, 4 nëntor 2020, 11 dhjetor 2020, konfidencial. Versioni i korrigjuar më tej i Aktakuzës së Konfirmuar u dorëzua më 3 shtator 2021, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte* (F00455/A01), me versionin e redaktuar konfidencial (F00455/CONF/RED/A01) dhe versionin e redaktuar publik (F00455/RED/A01). Më 17 janar 2022, Prokurori i Specializuar dorëzoi versionin konfidencial, të korrigjuar, me më pak redaktime të Aktakuzës së Konfirmuar, F00647/A01.

¹⁵ F00777, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Konfirmimin e Ndryshimeve në Aktakuzë*, 22 prill 2022, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, para. 183. Versioni i redaktuar (F00777/RED) u dorëzua më 6 maj 2022. Ndryshimet e kërkuara janë dhënë me hollësi në para. 11. Aktakuza e konfirmuar e ndryshuar u dorëzua më pas nga ZPS-ja më 29 prill 2022 (“Aktakuza e Konfirmuar”), rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte* (F00789/A01), me versionin e redaktuar konfidencial (F00789/A02) dhe versionin e redaktuar publik (F00789/A05). Aktakuza e konfirmuar e ndryshuar më tej, konfidenciale, u dorëzua më 30 shtator 2022, (F00999/A01), me versionin e redaktuar publik (F00999/A03). Versioni publik me më pak redaktime i Aktakuzës së Konfirmuar u dorëzua më 15 shkurt 2023 (F01296/A03) dhe 27 shkurt 2023 (F01323/A01).

¹⁶ *Shih, p.sh.*, IA008/F00004, Paneli i Gjykatës së Apelit, *Vendim mbi Apelin e Kadri Veselit kundër Vendimit mbi Rishikimin e Paraburgimit*, 1 tetor 2021, konfidencial, para. 21 (versioni i redaktuar publik u lëshua më të njëjtën ditë, IA008/F00004/RED).

2. Domosdoshmëria e paraburgimit

14. Në lidhje me arsyet për vazhdimin e paraburgimit, neni 41(6)(b) përcakton tri arsye (rreziqe) alternative, në bazë të të cilave mund të konstatohet se paraburgimi është i domosdoshëm: (i) rreziku i arratisjes; (ii) rreziku i pengimit të procesit; ose (iii) rreziku i kryerjes së veprave penale të tjera.¹⁷ Paraburgimi vazhdohet nëse ka arsye të artikulueshme për të besuar se një ose më shumë nga këto rreziqe do të materializohen.¹⁸ “Të artikulueshme” në këtë kontekst përdoret në kuptimin që të specifikuar me hollësi, duke iu referuar informacionit ose provave përkatëse.¹⁹ Gjatë vlerësimit nëse ekziston ndonjëri prej rreziqeve të përcaktuara në nenin 41(6)(b) për paraburgimin e një personi, standardi i zbatueshëm është më i ulët se pashmangshmëria, por më i lartë se thjesht mundësia që ndonjë prej rreziqeve të materializohet.²⁰

(a) Rreziku i arratisjes

15. ZPS-ja parashtron se z. Thaçi vazhdon të paraqesë rrezik për arratisje sepse është në dijeni të akuzave të rënda të konfirmuara kundër tij dhe tani, pas përfundimit të paraqitjes së provave nga ZPS-ja, ai ka njohuri të plotë për provat kundër tij, çka e bënë më konkret mundësinë e shqiptimit të dënimit me burgim të gjatë.²¹ Gjithashtu, ZPS-ja pretendon se z. Thaçi tani përballlet me akuza të konfirmuara në lidhje me orvatjet e pretenduara të tij për të penguar procesin dhe

¹⁷ *Krahaso ECtHR, Buzadji v. the Republic of Moldova* [GC], no. 23755/07, [Judgment](#), 5 July 2016 (“*Buzadji v. the Republic of Moldova* [GC]”), para. ECtHR, *Zohlandt v. the Netherlands*, no. 69491/16, [Judgment](#), 9 February 2021, para. 50; ECtHR, *Grubnyk v. Ukraine*, no. 58444/15, [Judgment](#), 17 September 2020, para. 115; ECtHR, *Korban v. Ukraine*, no. 26744/16, [Judgment](#), 4 July 2019, para. 155.

¹⁸ IA004/F00005, Paneli i Gjykatës së Apelit, *Vendim mbi Apelin e Hashim Thaçit kundër Vendimit lidhur me Lirimin e Përkohshëm* (“Vendimi i Parë i Apelit mbi Paraburgimin”), 30 prill 2021, konfidencial, para. 19 (versioni i redaktuar publik u lëshua më të njëjtën ditë, IA004/F00005/RED).

¹⁹ Neni 19.1.31 i Kodit të Procedurës Penale të Kosovës të vitit 2022, Ligji nr. 08/L-032, e jep këtë përkufizim për termin “artikulueshëm”: “pala e cila paraqet informacionin apo provën duhet të specifikojë në detaje informatën apo provën në të cilën mbështetet”.

²⁰ Vendimi i Parë i Apelit mbi Paraburgimin, para. 22.

²¹ Parashtrimet e ZPS-së, para. 14.

kryer vepra penale të tjera.²² ZPS-ja pretendon se këto rrethana shtojnë motivimin e z. Thaçi për t'u arratisur, duke krijuar mundësi mjaftueshmërisht reale që ai t'i ikë drejtësisë.²³

16. Trupi Gjykses vëren se ZPS-ja në thelb përsërit të njëjtat argumente që janë shqyrtuar dhe hedhur poshtë më parë nga Trupi Gjykses në vendime të mëhershme,²⁴ në lidhje me pikat vijuese: (i) z. Thaçi tani është i vetëdijshëm për akuzat e rënda të konfirmuara kundër tij; (ii) mundësinë e dënimit me burgim të gjatë nëse dënohet; (iii) z. Thaçi është njohur plotësisht me çështjen dhe provat e paraqitura kundër tij; dhe (iv) dijeninë e z. Thaçi për konfirmimin e akuzave kundër tij lidhur me veprat penale kundër administrimit të drejtësisë.²⁵ Në këtë drejtim, Trupi Gjykses rikujton konstatimin e Panelit të Gjykatës së Apelit se nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk duhet të pritët të shqyrtojë parashtrime të cilat vetëm përsërisin argumentet tashmë të trajtuara në vendimet e mëparshme mbi rishikimin e paraburgimit.²⁶ Trupi Gjykses gjykon se ky parim vlen njëjloj edhe për fazën aktuale të procesit.²⁷

17. Sa i përket argumentit të ZPS-së se dorëzimi i dosjes gjyqësore përfundimtare rrit rrezikun e arratisjes së z. Thaçi,²⁸ Trupi Gjykses rikujton konstatimet e veta të mëparshme në lidhje me mbylljen e paraqitjes së provave nga ZPS-ja dhe Mbrojtja e Viktimave dhe vlerëson se i njëjti arsyetim vlen edhe për këtë fazë të procesit.²⁹

²² Parashtrimet e ZPS-së, para. 14.

²³ Parashtrimet e ZPS-së, para. 14.

²⁴ *Krahaso* Parashtrimet e ZPS-së, para. 14. *me* F03596, Prokurorja e Specializuar, *Parashtrim i Prokurorisë në lidhje me Rishikimin e Rregullt të Paraburgimit të Hashim Thaçit*, 21 nëntor 2025, para. 13.

²⁵ *Shih* Vendimin e Njëzetekatërt për Paraburgimin, para. 16-17.

²⁶ *Shih* KSC-BC-2020-04, IA003/F00005/RED, Paneli i Gjykatës së Apelit, *Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Apelin e Pjetër Shalës kundër Vendimit mbi Rishikimin e Paraburgimit ("Vendimi mbi Apelin e Shalës")*, 11 shkurt 2022, para. 18.

²⁷ *Shih gjithashtu* Vendimin mbi Apelin e Shalës, para. 18, ku konstatohet se paneli mund t'u referohet konstatimeve të vendimeve të mëparshme nëse është bindur se provat ose informacioni mbi të cilat u bazuan këto vendime ende shërbejnë si bazë për konstatimet e bëra në kohën e rishikimit.

²⁸ Parashtrimet e ZPS-së, para. 11.

²⁹ F03514, Trupi Gjykses, *Vendim mbi Rishikimin e Rregullt të Paraburgimit të Hashim Thaçit*, 10 tetor 2025, para. 16.

18. Trupi Gjykses konstaton se, ndonëse rreziku i arratisjes nuk mund të përjashtohet plotësisht asnjëherë, ZPS-ja nuk ka arritur të vërtetojë pretendimin e vet se ekziston “mundësi mjaftueshëm reale” që i akuzuari të arratiset nëse lirohet, bazuar në argumentin e fazës së procesit gjyqësor.³⁰ Rrjedhimisht, Trupi Gjykses konstaton se vazhdimi i paraburgimit të z. Thaçi aktualisht nuk mund të përliqjet mbi bazën e rrezikut të arratisjes sipas nenit 41(6)(b)(i).

(b) Rreziku i pengimit të ecurisë së procesit të DHS-së

19. Duke iu referuar konstatimeve të mëparshme të këtij Trupi Gjykses, ZPS-ja parashtron se z. Thaçi vazhdon të paraqesë rrezik për pengimin e procesit.³¹ ZPS-ja argumenton se në Kosovë vazhdon të ekzistojë atmosferë e përgjithshme e ndërhyrjes ndaj dëshmitarëve të kësaj çështjeje gjyqësore dhe çështjeve të tjera gjyqësore në DHS,³² që, siç është konfirmuar nga Paneli i Gjykatës së Apelit, është një faktor kontekstual relevant.³³ Gjithashtu, ZPS-ja parashtron se: (i) mbyllja e paraqitjes së provave në këtë çështje nuk eliminon rrezikun, siç theksohet nga Trupi Gjykses,³⁴ pasi rreziku i pengimit për dëshmitarët mund të vazhdojë edhe pas përfundimit të dëshmive të tyre; dhe (ii) nxjerrja e informacionit tejet e të ndjeshëm për Mbrojtjen e z. Thaçi, përfshirë të akuzuarin, në mënyrë të pashmangshme rrit ekspozimin ndaj tij, duke rritur kështu rrezikun që ky informacion të bëhet publik dhe të rrezikojë mbrojtjen efektive të dëshmitarëve në rast se lirohet i akuzuari.³⁵ Në lidhje me këtë, ZPS-ja pretendon se ky rrezik është materializuar tashmë, sepse z. Thaçi ka shkelur urdhrin e Trupit Gjykses, ndër të

³⁰ *Shih* Vendimin e Parë të Apelit mbi Paraburgimin, para. 24.

³¹ Parashtrimet e ZPS-së, para. 15- 18, 20.

³² Parashtrimet e ZPS-së, para. 19.

³³ Parashtrimet e ZPS-së, para. 19 që i referohet IA017/F00011, Paneli i Gjykatës së Apelit, *Vendim mbi Apelin e Hashim Thaçit kundër Vendimit mbi Rishikimin e Paraburgimit* (“Vendimi i Tretë i Apelit mbi Paraburgimin”), 5 prill 2022, konfidencial, para. 41-48. Versioni i redaktuar publik u lëshua më të njëjten ditë, IA017/F00011/RED.

³⁴ Parashtrimet e ZPS-së, para. 16, që i referohen Vendimit të Njëzetekatërt për Paraburgimin, para. 20.

³⁵ Parashtrimet e ZPS-së, para. 16-17.

tjera: (i) duke u dhënë vizitorëve informacion të marrë gjatë dëshmime të dëshmitarëve të mbrojtur; dhe (ii) duke dhënë udhëzime për dëshmitarët e ardhshëm të ZPS-së në lidhje me mënyrën dhe përmbajtjen e dëshmisë së tyre të pritshme çka rezultoi në modifikimin prej Trupit Gjykses të kushteve të paraburgimit dhe në konfirmimin e akuzave kundër z. Thaçi në KSC-BC-2023-12 ("Çështja 12").³⁶ Sipas ZPS-së, kjo tregon se rreziku i pengimit të drejtësisë jo vetëm që është i bazuar mirë, por se z. Thaçi është përfshirë në mënyrë aktive në veprime që cenojnë sigurinë dhe mirëqenien e dëshmitarëve dhe dëmtojnë drejtpërdrejt integritetin e procesit gjyqësor, duke paraqitur kështu rrezik jashtëzakonisht të lartë për pengimin e procesit.³⁷

20. Trupi Gjykses ka konstatuar tashmë dhe përsërit se z. Thaçi: (i) ka interesin dhe aftësinë për të ndërhyrë në proces; (ii) është orvatur të dëmtojë DHS-në dhe u ka ofruar përfitime personave të thirrur nga ZPS-ja; (iii) ka pozitë me ndikim në Kosovë që i mundëson mbështetjen e simpatizuesve; dhe (iv) ka më shumë njohuri për provat që mbështesin akuzat e rënda kundër tij.³⁸

21. Trupi Gjykses rikujton se emrat dhe të dhënat personale të disa dëshmitarëve tejet të cenueshëm të ZPS-së janë nxjerrë për Mbrojtjen e Thaçit,³⁹ dhe, për rrjedhojë, do t'u bëhen të njohur më shumë personave, përfshirë z. Thaçi. Kjo, nga ana e saj, shton rrezikun që informacioni i ndjeshëm në lidhje me dëshmitarët të bëhet i njohur për publikun. Ky rrezik ekziston edhe pasi të kenë dhënë dëshmi dëshmitarët e ZPS-së, duke pasur parasysh se shumë nga këta dëshmitarë kanë masa mbrojtëse dhe identitetet e tyre nuk duhen të bëhen asnjëherë të njohur për publikun. Në pikëpamjen e Trupit Gjykses ky rrezik nuk ulet me mbylljen e

³⁶ Parashtrimet e ZPS-së, para. 18.

³⁷ Parashtrimet e ZPS-së, para. 20.

³⁸ Vendimi i Njëzetekatërt për Paraburgimin, para. 19. *Shih p.sh.* F00177, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën e Hashim Thaçit për Lirim të Përkohshëm* ("Vendimi i Parë mbi Paraburgimin e Thaçit"), 22 janar 2021, konfidencial, para. 38, 41 (versioni i redaktuar publik u lëshua më 26 janar 2021, F00177/RED).

³⁹ Shih Vendimin e Njëzetekatërt për Paraburgimin, para. 20.

paraqitjes së provave në këtë çështje gjyqësore. Gjithashtu, rreziku i ndërhyrjes që synon të parandalojë paraburgimi përfshin gjithashtu, për shembull: (i) çdo përpjekje për t'u hakmarrë ndaj dëshmitarëve që kanë dëshmuar në këtë proces; (ii) përpjekjet për të nxitur një dëshmitar të tërheqë dëshminë; dhe (iii) përpjekjet për të ndërhyrë te dëshmitarë në procese paralele.⁴⁰ Në lidhje me pikën e fundit, Trupi Gjykses vëren se procesi gjyqësor lidhur me akuzat për ndërhyrje në këtë çështje gjyqësore është në zhvillim e sipër dhe se dosja e çështjes i ka kaluar Gjykatësit të Vetëm.⁴¹

22. Në lidhje me këtë, Trupi Gjykses rikujton konstatimet e veta të mëparshme sipas të cilave duket se z. Thaçi: (i) u ka dhënë vizitorëve jo të privilegjuar informacion të marrë gjatë dëshmive të dëshmitarëve të mbrojtur; dhe/ose (ii) ka diskutuar udhëzime të cilat duhet t'u përcilleshin dëshmitarëve lidhur me formën dhe përmbajtjen e dëshmive të tyre.⁴² Këto konstatime mbështeten edhe nga fakti që tashmë ndaj z. Thaçi janë konfirmuar akuzat në Çështjen 12 dhe dosja e çështjes gjyqësore i ka kaluar Gjykatësit të Vetëm.⁴³ Në këtë kontekst, Trupi Gjykses gjykon se lirimi i z. Thaçi duke pasur informacion të ndjeshëm nuk do të kontribuonte në mbrojtjen e efektshme të dëshmitarëve.

⁴⁰ *Shih p.sh.* IA033/F00006, Paneli i Gjykatës së Apelit, *Vendim mbi Apelin e Rexhep Selimit kundër Vendimit Përmbledhës në lidhje me Kërkesën për Lirim të Përkohshëm dhe Rishikimin e Paraburgimit*, 13 gusht 2025, para. 49-52; F03176/COR2, Trupi Gjykses, *Version i Korrigjuar më tej i Vendimit Përmbledhës mbi Kërkesën e Mbrojtjes së Krasniqit për Lirim të Përkohshëm dhe për Rishikimin e Rregullt të Paraburgimit të Jakup Krasniqit*, 13 maj 2025, konfidencial, para. 41. Versioni i redaktuar publik u dorëzua më atë ditë, F03176/COR2/RED.

⁴¹ KSC-BC-2023-12, F00264/A02, Prokurorja e Specializuar, *Shtojca 2 e Parashtrimit të Aktakuzës së Konfirmuar të Ndryshuar*, ("Aktakuza në Çështjen 12"), 16 prill 2025; KSC-BC-2023-12, F00544, Gjykatësja e Procedurës Paraprake, *Vendim për Kalimin e Dosjes së Çështjes te Gjykatësi i Vetëm* ("Vendimi për Kalimin e Çështjes 12 te Gjykatësi i Vetëm"), 12 nëntor 2025.

⁴² *Shih* F01977, Trupi Gjykses, *Vendim i Mëtejshëm mbi Kërkesën Urgjente të Prokurorisë për Modifikimin e Kushteve të Paraburgimit për Hashim Thaçin, Kadri Veselin dhe Rexhep Selimin* ("Vendimi mbi Kushtet e Paraburgimit"), 1 dhjetor 2023, para. 35-39; F03442, Trupi Gjykses, *Vendim mbi Kërkesën e Prokurorisë për Ndryshimin e Listës së Provave Materiale*, 3 shtator 2025, konfidenciale dhe *ex parte*, para. 21-27 (versioni i redaktuar publik u lëshua më 10 tetor 2025, F03442/RED). Vendimi i Njëzetekatërt për Paraburgimin, para. 21.

⁴³ Aktakuza në Çështjen 12, para. 6-8, 45-46. Vendimi për Kalimin e Dosjes së Çështjes 12 te Gjykatësi i Vetëm, para. 28.

23. Gjithashtu, ky rrezik ekziston në një atmosferë të frikësimit të dëshmitarëve dhe ndërhyrjes në proceset penale kundër ish-anëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ("UÇK"), që nuk mund të kapërcehet vetëm me masa mbrojtëse.⁴⁴

24. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses gjykon se vazhdon të ekzistojë rreziku që z. Thaçi të pengojë ecurinë e procesit të DHS-së.

(c) Rreziku i kryerjes së krimeve të tjera

25. Duke iu referuar konstatimeve të mëhershme të Trupit Gjykses në Vendimin e Njëzetekatërt për Paraburgimin, ZPS-ja parashtron se vazhdon të ekzistojë rreziku që z. Thaçi të kryejë krime të tjera.⁴⁵ Gjithashtu, ZPS-ja parashtron se rrethanat relevante që u morën parasysh për vlerësimin e rrezikut të pengimit të ecurisë së procesit të DHS-së janë njëlloj të vlefshme për këtë pikë dhe për rrjedhojë i përfshin edhe ato.⁴⁶ ZPS-ja parashtron se fakti që z. Thaçi tani ka njohuri konkrete për çështjen në përgjithësi dhe provat kundër tij rrit rrezikun që ai të kryejë vepra penale të tjera, përfshirë kundër dëshmitarëve që kanë dhënë ose mund të japin dëshmi në këtë çështje gjyqësore dhe/ose mund të paraqiten para këtij Trupi Gjykses në faza të ardhshme të procesit.⁴⁷

26. Trupi Gjykses rikujton konstatimin e vet në Vendimin e Njëzetekatërt për Paraburgimin se vazhdon të ekzistojë rreziku që z. Thaçi të kryejë vepra penale të tjera.⁴⁸ Trupi Gjykses konstaton se të njëjtët faktorë që u morën parasysh në lidhje me rrezikun e pengimit të procesit vlejné dhe për shqyrtimin e rrezikut të kryerjes

⁴⁴ Vendimi i Njëzetekatërt për Paraburgimin, para. 22. *Shih gjithashtu* KSC-BC-2020-05, F00494/RED, Trupi Gjykses, *Aktgjykim*, 19 janar 2023, para. 57 (versioni i korrigjuar u dorëzua më 8 qershor 2023, F00494/RED3/COR).

⁴⁵ Parashtrimet e ZPS-së, para. 21, që u referohen Vendimit të Njëzetekatërt për Paraburgimin, para. 24-26.

⁴⁶ Parashtrimet e ZPS-së, para. 22.

⁴⁷ Parashtrimet e ZPS-së, para. 25.

⁴⁸Vendimi i Njëzetekatërt për Paraburgimin, para. 25.

së veprave penale të tjera nga z. Thaçi.⁴⁹ Trupi Gjykses vë në dukje gjithashtu se, siç u shtjellua më lart,⁵⁰ përfundimi i paraqitjes së provave nga ZPS-ja nuk ndryshon konstatimin e Trupit Gjykses. Bazuar në këta faktorë, Trupi Gjykses konstaton se, që nga rishikimi i fundit i paraburgimit, nuk ka ndryshuar asnjë nga rrethanat që do të përligjin një konstatim të ndryshëm në lidhje me këtë pikë.

27. Trupi Gjykses gjykon se, duke marrë parasysh të gjithë faktorët së bashku, vazhdon të ekzistojë rreziku që z. Thaçi të kryejë krime të tjera sikurse përcaktohet në nenin 41(6)(b)(iii).

3. Përfundim

28. Trupi Gjykses arrin në përfundimin se aktualisht nuk ka informacion të mjaftueshëm që të përligjë konstatimin se z. Thaçi mund t'i ikë drejtësisë, në qoftë se lirohet. Megjithatë, në bazë të standardit përkatës, Trupi Gjykses është bindur se ekziston rreziku që z. Thaçi të pengojë ecurinë e procesit të DHS-së dhe të kryejë krime të tjera kundër atyre që konsiderohen se janë kundër UÇK-së, ku përfshihen dëshmitarë që kanë dhënë ose mund të japin dëshmi në këtë çështje dhe/ose mund të thirren në procese gjyqësore paralele. Trupi Gjykses do të vlerësojë në vijim nëse kushtet për lirimin e tij mund të trajtojnë në mënyrën e duhur këto rreziqe.

B. MASAT ALTERNATIVE NDAJ PARABURGIMIT

29. Duke iu referuar konstatimeve të mëparshme të Trupit Gjykses, ZPS-ja parashtron se: (i) rreziqet në fjalë mund të trajtohen në mënyrë efektive vetëm në objektin e paraburgimit të DHS-së.⁵¹ (ii) asnjë prej kushteve të propozuara më parë dhe as masat shtesë të parapara në nenin 41(12) nuk mund të zbusin mjaftueshëm

⁴⁹ Shih më lart, para. 19-24; Vendimi i Njëzetekatërt për Paraburgimin, para. 25.

⁵⁰ Shih më lart, para. 21.

⁵¹ Parashtrimet e ZPS-së, para. 26.

rreziqet ekzistuese;⁵² (iii) komunikimet e z. Thaçi mund të kufizohen në një mënyrë që do të zvogëlonte mjaftueshëm rreziqet e pengimit të procesit dhe të kryerjes së krimeve të tjera vetëm me anë të kornizës për monitorimin e komunikimeve në objektin e paraburgimit të DHS-së; ⁵³ (ii) asgjë nuk ka ndryshuar që nga Vendimi i Njëzetekatërt për Paraburgimin, që do të përligjte një vlerësim të ndryshëm të kushteve, qoftë në përgjithësi apo për një periudhë të caktuar kohore;⁵⁴ dhe (v) ZPS-ja parashtron gjithashtu se z. Thaçi tani përbën rrezik jashtëzakonisht të shtuar, sa që as kufizimet standarde të komunikimit dhe monitorimi në objektin e paraburgimit të DHS-së nuk janë të mjaftueshme për zvogëlimin e tij.⁵⁵

30. Gjatë marrjes së vendimit nëse një person duhet të lirohet apo të mbahet në paraburgim, Trupi Gjykes duhet të shqyrtojë masat alternative për parandalimin e rreziqeve në nenin 41(6)(b).⁵⁶ Neni 41(12) përcakton disa faktorë që duhet të merren parasysh për të mundësuar praninë e të akuzuarit në gjykim, për të parandaluar përsëritjen e veprës penale apo për të garantuar kryerjen me sukses të procesit penal. Në këtë aspekt, Trupi Gjykes rikujton se paraburgimi duhet të vazhdojë vetëm në qoftë se logjikisht nuk ekzistojnë masa alternative më të buta të cilat do të zvogëlonin mjaftueshëm rreziqet e përcaktuara në nenin 41(6)(b).⁵⁷

⁵² Parashtrimet e ZPS-së, para. 27.

⁵³ Parashtrimet e ZPS-së, para. 29.

⁵⁴ Parashtrimet e ZPS-së, para. 30.

⁵⁵ Parashtrimet e ZPS-së, para. 30.

⁵⁶ Në lidhje me detyrimin për të shqyrtuar “masa alternative”, shih KSC-CC-PR-2017-01, F00004, Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese, *Aktvendim mbi Referimin e Rregullores së Procedurës dhe të Provave Miratuar nga Plenarja më 17 mars 2017, Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese sipas Nenit 19(5) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar* (“Aktvendimi i DHSGJK-së i 26 Prillit 2017”), 26 prill 2017, para. 114. Shih gjithashtu ECtHR, *Buzadji v. the Republic of Moldova [GC]*, para. 87 *in fine*; 87 *in fine*; ECtHR, *Idalov v. Russia [GC]*, no. 5826/03, [Judgment](#), 22 May 2012 (“*Idalov v. Russia [GC]*”), para.

⁵⁷ Aktvendimi i DHSGJK-së i 26 Prillit 2017, para 114; KSC-CC-PR-2020-09/F00006, Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese, *Aktvendim mbi Referimin e Ndryshimeve të Rregullores së Procedurës dhe të Provave të Miratuara nga Plenarja më 29 dhe 30 prill 2020*, 22 maj 2020, para. Shih gjithashtu ECtHR, [Idalov v. Russia \[GC\]](#), para. 140.

Për këtë arsye, Trupi Gjykses duhet të shqyrtojë të gjitha masat e arsyeshme alternative që mund të merren dhe jo vetëm ato që parashtrajnë palët.⁵⁸

31. Në lidhje me rrezikun e pengimit të ecurisë së procesit të DHS-së dhe kryerjes së krimeve të tjera, Trupi Gjykses rikonfirmon se asnjë nga masat e përcaktuara në nenin 41(12) nuk mund të zvogëlojë mjaftueshëm rreziqet ekzistuese.⁵⁹ Gjithashtu, Trupi Gjykses konstaton se masat në fuqi në objektin e paraburgimit të DHS-së, të marra në tërësi, ofrojnë garanci të forta kundrejt vizitave dhe komunikimeve të pambikëqyrura me anëtarët e familjes dhe vizitorët e miratuar paraprakisht, me synimin për të zvogëluar rrezikun e pengimit të procesit dhe të kryerjes së krimeve të tjera.⁶⁰ Për më tepër, ato ofrojnë një mjedis të kontrolluar ku një shkelje e mundshme e konfidencialitetit mund të identifikohet dhe/ose të parandalohet me lehtësi.⁶¹

32. Trupi Gjykses rikonfirmon më tej se, vetëm me anë të kornizës për mbikëqyrjen e komunikimeve në objektin e paraburgimit të DHS-së, përfshirë masat që urdhëroi Trupi Gjykses,⁶² komunikimet e z. Thaçi mund të kufizohen në një mënyrë që zvogëlon mjaftueshëm rrezikun e pengimit të procesit dhe të kryerjes së krimeve të tjera.⁶³

33. Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykses konstaton se rreziku i pengimit të procesit dhe i kryerjes së krimeve të tjera mund të administrohet në mënyrë efektive vetëm në objektin e paraburgimit të DHS-së. Në këto rrethana, Trupi Gjykses gjykon se

⁵⁸ IA003/F00005, Paneli i Gjykatës së Apelit, *Vendim mbi Apelin e Rexhep Selimit kundër Vendimit mbi Lirimin e Përkohshëm*, 30 prill 2021, konfidencial, para. 86 (versioni i redaktuar publik u lëshua më atë ditë, IA003/F00005/RED). KSC-BC-2020-05, F00127, Trupi Gjykses I, *Vendimi i Katërt mbi Rishikimin e Paraburgimit*, 25 maj 2021, publik.

⁵⁹ Vendimi i Njëzetekatërt për Paraburgimin, para. 30.

⁶⁰ Vendimi i Njëzetekatërt për Paraburgimin, para. 30.

⁶¹ Vendimi i Njëzetekatërt për Paraburgimin, para. 30.

⁶² Vendimi mbi Kushtet e Paraburgimit, para. 84(c); F03308, Trupi Gjykses, *Vendim për Rishikimin e Kushteve të Paraburgimit të Modifikuar në Vendimin F01977*, 4 korrik 2025, konfidencial, para. 71-72, 91-92, 113(b).

⁶³ Vendimi i Njëzetekatërt për Paraburgimin, para. 31.

vazhdimi i paraburgimit të z. Thaçi është i domosdoshëm për të shmangur rreziqet në nenin 41(6)(b)(ii) dhe (iii).

C. ARSYESHMËRIA E PARABURGIMIT

34. Duke iu referuar konstatimit të mëparshëm të Trupit Gjykses, ZPS-ja parashtron se mbajtja në paraburgim e z. Thaçi vazhdon të jetë proporcionale dhe e arsyeshme, sidomos duke pasur parasysh ecurinë e arsyeshme në vijimësi të gjykimit.⁶⁴

35. Trupi Gjykses rikujton se arsyeshmëria për vazhdimin e paraburgimit të të akuzuarit duhet të vlerësohet bazuar në faktet e secilës çështje dhe sipas veçorive të saj.⁶⁵ Ndër veçoritë e kësaj çështjeje gjyqësore përfshihen: (i) ndikimi dhe autoriteti i z. Thaçi; (ii) njohja me akuzat dhe provat kundër tij dhe mundësinë e dënimit me burgim të gjatë; (iii) rreziku që z. Thaçi të pengojë procesin e DHS-së; (iv) rreziku i kryerjes, nxitjes ose dhënies së ndihmës për krime të tjera; (v) fakti që masat kufizuese për lirimin nuk janë të mjaftueshme për të zvogëluar rreziqet; dhe (vi) pesha dhe kompleksiteti i akuzave kundër z. Thaçi.⁶⁶

36. Bazuar në këto rrethana dhe faktin se vazhdojnë të ekzistojnë rreziqet e pengimit të procesit dhe të kryerjes së krimeve të tjera – që nuk mund të zvogëlohen mjaftueshëm me zbatimin e masave të arsyeshme alternative – Trupi Gjykses konstaton se, në rrethanat specifike të kësaj çështjeje, vazhdimi i paraburgimit të z. Thaçi me dy muaj të tjerë është i domosdoshëm dhe i arsyeshëm.

37. Megjithatë, Trupi Gjykses thekson se z. Thaçi tashmë mbahet në paraburgim për një periudhë të konsiderueshme kohore dhe gjykimi i kësaj çështjeje është i

⁶⁴ Parashtrimet e ZPS-së, para. 31-32, që u referohen Vendimit të Njëzetekatërt për Paraburgimin, para. 34-35.

⁶⁵ Vendimi i Tretë i Apelit mbi Paraburgimin, para. 65.

⁶⁶ Vendimi i Njëzetekatërt për Paraburgimin, para. 34.

gjatë. Sikurse u vu në dukje më herët nga Trupi Gjykses, kjo kërkon që Trupi Gjykses dhe palët të kenë veçanërisht parasysht që të mundësojnë kryerjen sa më të shpejtë të gjykimit. Trupi Gjykses do të vazhdojë të monitorojë në çdo fazë të këtij procesi nëse vazhdimi i paraburgimit është i domosdoshëm dhe i arsyeshëm.

V. VENDIM

38. Për arsyet e përmendura më lart, Trupi Gjykses:

- (a) **URDHËRON** vazhdimin e paraburgimit e z. Thaçi; dhe
- (b) **URDHËRON** ZPS-në të dorëzojë parashtrime në lidhje me rishikimin e ardhshëm të paraburgimit të z. Thaçi jo më vonë se të **hënën, 20 mars 2026 në orën 16:00**, me përgjigjet dhe kundërpërgjigjet sipas afateve të përcaktuara në rregullën 76.

/nënshkrimi/

Gjykatës Çarls L. Smith, III
Kryegjykatës

E martë, 10 shkurt 2026

Në Hagë, Holandë.